



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:110759

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05557958

C.nr.483/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokatja B.B nga Prizreni, ndaj të paditurit L.S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati P.K nga Gjakova, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit jo material, me vlerën e objektit të kontestit prej 16,200.00 euro, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 26.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PA BAZUAR kërkesëpadia e paditësit S.S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET i padituri L.S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, që në emër të dëmit jomaterial të i kompensoj shumën e përgjithshme në lartësi prej 16,200.00 euro me kamatë ligjore prej 8% të llogaritur nga data 01.06.2021 (data e ushtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive dhe atë në emër të të gjitha formave të frikës shumën prej 5,500.00 euro, për shkak të cenimit të autoritetit shumën prej 1,200.00 euro, në emër të shqetësimeve shpirtërore, stresit dhe depresionit të krijuar përmes kallëzimit penal shumën prej 7,500.00 euro dhe për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor – fitimin e humbur shumën prej 2,000.00 euro.

II. DETYROHET e paditësi S.S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, që paditësit L.S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, t'ia paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 1289.60 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi S.S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 01.06.2021 në këtë gjykatë ka parashtruar padinë ndaj të paditurit L.S nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit jo material, me vlerën e objektit të kontestit prej 16,200.00 euro.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se mbetet në tërësi si në padi, të ushtruar në këtë gjykatë dhe deklarimeve në seancat gjyqësore, si dhe precizimin e kërkesëpadisë, të paraqitur pranë kësaj gjykate me datë 27.02.2024, duke theksuar se nga elaborimi i të gjitha provave në këtë procedurë

kontestimore pa dyshim u vërtetua fakti se paditësi S.S me rastin e ushtrimit të kallëzimit penal nga ana e të paditurit L.S, ka përjetuar shqetësime të vazhdueshme, të reflektuara përmes stresit, dhembjeve shpirtërore, të manifestuara në forma të ndryshme, deri në depresioni, si shkallë e fundit e këtyre shqetësimeve psikike. Një gjë e tillë u vërtetua edhe përmes dëgjimit të paditësit S.S në seancën e sotme gjyqësore, përmes vizitës së bërë te psikiatri Dr. Z K dhe së fundi këto pretendime të paditësit janë vërtetuar në tërësi si të bazuara përmes edhe të ekspertizës së ekspertit të licencuar gjyqësor Dr. N F, gjatë ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit S.S në ekspertizën e vet, në mënyrë të qartë dhe profesionale ka përshkruar të gjitha shqetësimet që ka përjetuar paditësi pas ushtrimit të kallëzimit penal ndaj tij, shqetësime këto të reflektuara në formë të frikës së përjetuar, traumave dhe dhembjeve shpirtërore, si rezultat i një paraqitjeje të rremë ndaj tij, kinse për falsifikim dokumentesh. Paditësi ka shqetësime të theksuara që nga momenti i ushtrimit të kallëzimit penal ndaj tij dhe deri më tani në vazhdimësi ka shqetësime të klasifikuara si përjetime të shkallës së intensitetit të lartë, të mesëm dhe të ulët, këto përjetime të cilat paditësin e kanë bërë që të mos e ndiejë veten të sigurt, të ketë shqetësime në momentin kur takohet me ndonjë postier, ose me policinë, duke menduar se çdo gjë është e drejtuar kundër tij. Andaj, pas të gjitha të lartcekurave, i propozojmë gjykatës që ta aprovojë në tërësi si të bazuar padinë e paditësit, sipas precizimit të dorëzuar në këtë gjykatë, me datë 27.02.2024, si dhe të gjitha këto me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë, 01.06.2021, sipas nenit 382 të LMD-së e deri në pagesën definitive, si dhe të i kompensojë të gjitha shpenzimet sipas tarifës së OAK-së dhe atë: Për padi 208.00 Euro, për seanca gjyqësore të mbajtura, për një seancë 270.40 Euro, për seancat që nuk janë mbajtur 50% të kësaj shume, respektivisht 135.20 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

I padituri L.S, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, në përgjigjen në padi, në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave materiale dhe personale, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, nuk u arrit të vërtetohet baza e kërkesëpadisë se këtu i padituri i ka shkaktuar dëm paditësit me paraqitjen e kallëzimit penal të datës 18.02.2020. Gjatë këtij shqyrtimi paditësi ka dështuar ta argumentojë padinë dhe kërkesëpadinë. Nga provat materiale është konstatuar se paditësi ka përjetuar dhembje të intensitetit të lartë në muajin e parë, dhembje shpirtërore të intensitetit të mesëm, që ka vazhduar për 3 muaj, dhembje shpirtërore të intensitetit të ulët, që ka vazhduar deri në kryerjen e plotë të pretendimeve të hetuara, konstatuar nga ekspertiza psikiatrike e Dr. N.F, kjo gjendje është në kundërshtim me kohën kur është paraqitur kallëzimi penal nga i padituri, po ashtu, edhe nga vetë deklarimi i paditësit në këtë shqyrtim, i njëjti thekson se ndaj tij janë paraqitur shumë kallëzime penale dhe po ashtu, i njëjti deklaron se në vitin 2021, e ka paraqitur një ankesë i padituri se kinse gjendja është e tensionuar dhe janë duke u rrahur dhe aty ka shkuar Njësia Speciale e policisë, ku edhe si pasojë të paditësi ka shkaktuar frikë, ankth dhe shqetësime tjera, pra, edhe nga vetë deklarimi i paditësit nuk mund të vërtetohet gjendja faktike sikur në kërkesëpadi se në veprimet e të paditurit, paditësit i është shkaktuar dëmi i pretenduar, nga deklarimi i paditësit nuk mund të vërtetohet viti dhe koha e saktë se kur paditësi i ka përjetuar dhembjet shpirtërore dhe po ashtu, paraqitja e kallëzimit penal nga i padituri nuk përputhet me kohën kur paditësi ka përjetuar stres, ankth e të tjera. Gjykata duhet ta refuzojë kërkesëpadinë si të pabazuar dhe po ashtu, bazuar në ekspertizën psikiatrike dhe deklaratimet e paditësit të cilat janë në kundërshtim me njëra-tjetrën,

pasi ekspertiza nuk e përcakton saktë kohën kur paditësi ka përjetuar dhembje shpirtërore, me kohën të cilën e deklaroi këtu paditësi. Gjykata duhet të ia falë besimin të paditurit, sepse i njëjti nuk e ka kontestuar se ka paraqitur një kallëzim penal ndaj paditësit, pasi për të, si qytetar, ka qenë e dyshimtë se i njëjti ka mundur të kryejë një veprë penale, po ashtu, deklarimi i tij është edhe si obligim qytetar dhe penale që në rast se një qytetar mund të dyshojë për një veprë penale të kryer, i njëjti është i obliguar që ta paraqesë pranë organeve të drejtësisë, pa qenë i vetëdijshëm se ajo veprë është e vërtetë apo e pavërtetë. Andaj, nga provat e administruara, gjykatës i propozoj që ta refuzojë padinë dhe kërkesën e precizuar si të pabazuar dhe të paprovuar në këtë shqyrtim kryesor, po ashtu, ta obligojë paditësin që të paditurit të ia kompensojë shpenzimet procedurale dhe atë: Për 4 seanca të mbajtura shumë prej 1081.60 Euro, për përgjigje në padi shumë prej 208.00 Euro, e gjithsej shumë e përgjithshme 1289.60 Euro.

Gjykata ka lejuar ndryshimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv, konform nenit 258.1 të LPK-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 26.03.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë:

- Aktvendim për hüdhen e kallëzimit penal PPN/II.nr.62/2020, i datës 26.01.2021, i Prokurorisë Themelore Gjakovë;
- Ekspertizë psikiatrike, e punuar nga eksperti Dr. Sci. N.F, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 17.11.2023, nëpërmjet postës dhe e pranuar nga kjo gjykatë me datë 23.11.2023.

Gjithashtu gjykata në cilësi të palës ka dëgjuar edhe paditësin S.S dhe të paditurin L.S.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 7 dhe 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore kontestuese është baza juridike e kërkesëpadisë si dhe lartësia e kërkesës.

Me administrimin e Aktvendim për hüdhen e kallëzimit penal PPN/II.nr.62/2020, i datës 26.01.2021, i Prokurorisë Themelore Gjakovë, gjykata vërtetoi faktin se i padituri L.Snë Prokurorinë Themelore në Gjakovë ka paraqitur kallëzimin penal ndaj paditësit S.S për shkak të dyshimit se kishte për të kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së. Prokuroria Themelore në Gjakovë më datën 26.01.2021 e ke hedhur kallëzimin penal ndaj paditësit për shkak se nuk kishte prova për vërtetimin e dyshimit të arsyeshëm se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është paraqitur kallëzimi penal.

Me administrimin e Ekspertizë psikiatrike, e punuar nga eksperti Dr. Sci. N.F, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 17.11.2023, nëpërmjet postës dhe e pranuar nga kjo gjykatë me datë 23.11.2023, eksperti në këtë ekspertizë ka konstatuar se ngritja e kallëzimit penal, procedurat e hetimit nga policia dhe deri në marrjen e aktvendimit për hedhjen poshtë të kallëzimit penal nga Prokuroria Themelore në Gjakovë kanë shfaqur efekt të përjetimit të stresit të nivelit traumatik për shkak të përjetimit kërcënues të integritetit dhe autoritetit moral dhe frikës që i ka shkaktuar ndryshime

në rrjedhën normale psikosociale të jetës të cilat kanë ndikuar në rrjedhën normale psikosociale të jetës të cilat kanë ndikuar negativisht në personalitetin e tij dhe në veprimtarinë e përditshme duke nxitur në këtë mënyrë një gjendje jo të mirë shpirtërore prej së cilës ka pasur ankth/frikë, pasiguri, mërzitje, vështirësi në përballimin e situatave jetësore, ndjeshmëri emocionale të lartë, mendime traumatike, mosbesim, çrregullime të gjumit, ide suicidale dhe tërheqje sociale. Bazuar në këtë ai përjeton dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë në muajin e parë. Kjo dhimbje është e shprehur në formë të shfaqjes së emocioneve negative si turpit, mërzitjeve, vështirësive të gjumit, humbjes së oreksit, akumulim të zemërimit dhe inatit. Dhimbja shpirtërore e intensitetit të mesëm që ka vazhduar për tre muaj në formë të ankthit, nervozizmit, irritabilitetit, ndjeshmërisë së tepruar, indisponimit dhe përfshirjes së sikletshme në aktivitete familjare dhe shoqërore. Dhimbja shpirtërore e intensitetit të ulët ka vazhduar deri në kryerjen e plotë të pretendimeve të hetuara të shprehur në formë të mendimeve negative, anktheve të kohëpaskohshme, humbjes së vullnetit, koke dhimbjeve, marramendjes, vështirësive të gjumit dhe dëshpërimit.

Gjykata ka ftuar ekspertin e psikiatrisë Dr. N.F në shqyrtimin kryesor të datës 21.02.2024, i cili në këtë seancë ka deklaruar se qëndron pranë ekspertizës së punuar, duke u përgjigjur në pyetjet e palëve ndërgjyqëse ka deklaruar se ashtu siç e kam konstatuar edhe në ekspertizë këto karakteristika të çrregullimit dhe përjetimit të dhimbjes shpirtërore i kemi lidhur që nga kallëzimi penal që është bërë ndaj paditësit S.S dhe këtë e kemi bazuar po ashtu edhe në një raport specialistik nga poliklinika Infermiera në Gjakovë të psikiatrit Dr. Z.K të datës 30.08.2021 ku ka vendosur një diagnozë me emër çrregullim i stresit post traumatik dhe çrregullim depresiv. Diagnoza e çrregullimit të stresit post – traumatik i jepet kur një person përjeton një traumë dhe zakonisht pas përjetimit të asaj traume pas një periudhe një mujore shfaqen shenjat e shqetësimit emocional si psh. frikë, ankth, mendime negative, çrregullimet e gjumit, vështirësi të koncentrimit si dhe vështirësi funksionale në jetën e përditshme. Fillimi i procedurave ka qenë me datë 18.02.2020 kurse raporti specialistik është lëshuar me datën 30.08.2021, avokati me të drejtë e bënë këtë pyetje por diagnoza e vendosur nga mjeku psikiatër i çrregullimit të stresit post traumatik është një diagnozë që vendoset pas përjetimit të një traume pasi të kalojë një periudhë një mujore nga ai përjetim. Kjo diagnozë nuk mund të vendoset pa përjetuar një traumë një person. Personat të ndryshëm mund të vendosin t’i drejtohen mjekut varësisht nga periudha e ballafaqimit të tyre me vështirësitë psikologjike që i kanë sepse ata mund të luftojnë dhe mund të mendojnë që mund të ia dalin edhe pa ndihmën e mjekut por kur e shohin që situata po përkeqësohet mund të vendosin të kërkojnë ndihmë. Në rastin konkret po të mos ishte vendosur diagnoza e çrregullimit të stresit post traumatik dhe të ishte vetëm çrregullim depresiv do të ishte më e vështirë ta shpjegojmë lidhjen me rastin konkret sepse një çrregullim depresiv mund të vjen për shkaqe shumë faktoriale, kurse çrregullimi i stresit post traumatik lidhet direkt me përjetimin e një traume.

Gjykata pjesërisht i fali besimin ekspertizës së punuar nga eksperti i psikiatrisë Dr. N.F. Në lidhje me këtë ekspertizë edhe pse i njëjti ka konstatuar se si rezultat i kallëzimit penal të paraqitur në Prokurorinë Themelore në Gjakovë paditësit S.S i është shkaktuar stresi post traumatik dhe çrregullimi depresiv, në këtë pikë vetë deklarimi i paditësit S.S në cilësinë e palës e ka demantuar lidhjen kauzale të diagnozës së përshkruar nga eksperti për shkak se i njëjti ka deklaruar se stresi që i është shkaktuar të njëjtit rrjedh nga disa raste që i kishin paditësi me familjen e të paditurit

e njëri ndër ta kishte qenë kur Njësia Speciale e Policisë së Kosovës kishte intervenuar në pronën e tyre kur ata ishin duke u përlëshur në mes veti, ndërsa një rast tjetër kishte qenë kur një oficer policie e kishte marrë në pyetje. Prandaj, gjykata nuk e konteston faktin se eksperti e ka caktuar diagnozën e duhur sipas ekspertizës, mirëpo në rastin konkret lidhjen kauzale të diagnozës së përshkruar me rastin e paraqitur në një masë të madhe edhe e ka vënë në dyshim pikërisht deklarimi i paditësit në cilësi të palës.

Gjatë dëgjimit në cilësi të palës, paditësi S.S ka deklaruar se më herët kam pasur pak presion, por që nga viti 2021, natën nuk po mund të fle, po më dalin në ëndërr policia dhe po më dhemb koka, po më humb memoria. Shpesh herë po më shkon si në vaj për shkak të memories dhe më dhemb edhe gjoksi. Gjithashtu, më dhembin edhe këmbët me të madhe. Nganjëherë kur po më humb memoria, po më vjen edhe ta vras veten. Në pyetjen e përfaqësueses së paditësit se a është filluar ndonjë procedurë penale ndaj jush më herët, i njëjti është përgjigjur se shumë herë janë zhvilluar procedura penale ndaj meje dhe ka deklaruar se asnjëherë nuk është dënuar. Në pyetjen e përfaqësuesit të autorizuar të të paditurit se Po këtë stres dhe këtë frikë për cilat vite e ke fituar, paditësi është përgjigjur se stresi më ka filluar më herët, por në vitin 2021 më u teprua sepse më ka ardhur Njësia Speciale e Policisë së Kosovës. Ndërsa në pyetjen pasuese të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit është përgjigjur se sipas deklaratës së L që e ka thirrur policinë arsyeja është se ata kanë ardhur, sepse gjoja ne jemi duke u rrahur me palën tjetër.

Gjykata i fali besimin deklaramit të paditësit për shkak se deklarata e tij përputhet edhe me provat tjera të administruara në këtë çështje kontestimore.

Gjatë dëgjimit në cilësi të palës, i padituri L.Ska deklaruar se vonë e kam kuptuar se është bërë testamenti, unë kam shkuar në kadastër për të nxjerr subvencione për misër, kam shkuar gjithmonë ashtu siç i kam nxjerr në emër të axhës H (S) S dhe më kanë thënë se nuk ka pronë në emër të H. Më pas ma kanë dhënë numrin e testamentit dhe kam ardhur në gjykatë, e kam gjetur lëndën, që paditësi S.S e ka bërë testamentin. Që 36 vjet jemi të ndarë me paditësin S.S dhe tokën e punojmë përgjysmë, ku gjysmën e punoj unë, ndërsa gjysmën ai. Më pas kam dyshuar se mos e ka falsifikuar testamentin, kam kontaktuar me avokatin dhe kemi paraqitur rastin në prokurori, prokurori na ka marr në pyetje mua dhe S, e më pas çka ka ndodhur nuk e di.

Gjykata gjithashtu i fali besimin deklaramit të të paditurit për shkak se deklarata e tij përputhet edhe me provat tjera të administruara në këtë çështje kontestimore.

Gjykata, bazuar në thëniet e paditësit dhe nga rrjedha e procedurës, ka ardhur në përfundim se në këtë rast, ligj i aplikueshëm është Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i vitit 2012, ngase paditësi pretendon se dëmi i është shkaktuar nga viti 2020, kur është ftuar në prokurori për deklaram në lidhje me veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së.

Në kuptim të aplikimit të dispozitave materiale, gjykata fillimisht sqaron për palët se padia e palës paditëse është refuzuar nga shkaku se të njëjtës i mungon baza juridike, pavarësisht nëse paditësi ka pasur apo jo dhimbje shpirtërore apo cenim të dinjitetit, siç ai e ka theksuar gjatë shqyrtimit, por që në këtë procedurë është vërtetuar edhe se paditësit në fakt nuk i është shkaktuar asnjë lloj dëmi.

Lidhur me dëmin të cilin e pretendon paditësi se i është shkaktuar nga ana e të paditurit, ku ky i fundit ka paraqitur kallëzimin penal në Prokurorinë Themelore në Gjakovë për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 i KPRK-së, gjykata thekson se dispozitat ligjore në këtë rast të kompensimit të dëmit material, përcaktojnë se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, paraparë me nenin 136 par.1 të LMD-së. Pra, në mënyrë që pala e paditur ta kompensojë në këtë rast palën paditëse, fillimisht duhet të provohet fakti se dëmi është shkaktuar me fajin e palës së paditur. Nga vetë përmbajtja dispozitës ligjore të parashikuar nga neni 136 par.1 rrjedh se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrimin t’ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite, për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktuesi i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Në këtë kuptim, duhet të plotësohet kushti se nga rrjedhë dëmi i shkaktuar. Kurse Neni 137 i LMD-së parasheh se *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*. Dëmi natyror është ndryshimi ndërmjet gjendjes reale dhe gjendjes që do të ishte sikur të mos paraqitej rasti dëmtues, nëse kjo gjendje e mëvonshme, sikur të mos paraqitej rasti, do të ishte më e mirë. Kështu, kusht është që të paraqitet ky ndryshim ndërmjet gjendjes reale ekzistuese dhe asaj pa paraqitjen e rastit dëmtues, i cili edhe do të përbënte dëm.

Gjykata vlerëson se tek rastet e shpërblimit të dëmit duhet të plotësohen disa kushte siç janë: a) ekzistenca e dëmit, b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit, c) ekzistenca e fajit, dhe d) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur. Rrjedhimisht, tek rasti kontestues nuk është përmbushur asnjë element, qoftë ekzistenca e dëmit, ekzistenca e paligjshmërisë, ajo e fajit dhe ekzistenca e lidhjes kauzale apo shkakore, që do të tërhiqte pas vetes edhe fajin më pastaj. Gjykata vlerëson se për të lindur përgjegjësia civile, nuk mjafton vetëm konstatimi i dëmit, mirëpo duhet të ekzistoj edhe një raport shkak-pasojë. Pra, duhet provuar që ky dëm e ka burimin si rezultat i veprimit ose mosveprimit të palës së paditur, por që në këtë rast nuk është provuar të ketë ekzistuar ndonjë lloj i dëmit, e që është shkaktuar nga i padituri.

Lidhja shkakore paraqet raportin e ndërsjellët, ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e tij. Pra lidhja kauzale është një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Çdo ngjarje që është kusht për dëmin, d.m.th., pa të cilin ky dëm nuk do të kishte ndodhur, konsiderohet si një shkak dhe e detyron të paditurit të shpërblejë dëmin. Së këndejmi lidhja kauzale duhet të jetë e atillë që duhet të dëshmojë për ngjarjen e cila sigurt është shkaktuar si pasojë e veprimit apo mosveprimit të të paditurit.

Në këtë shqyrtim, në mënyrë të pa kontestuar është provuar fakti se pala e paditur, në asnjë mënyrë, qoftë me veprim apo me mos veprim, të ketë kontribuar në dëmin që paditësi pretendon se i është shkaktuar. Është provuar se i padituri pasi që ka dyshuar se testamenti i përpiluar nga paraardhësi i palëve është i falsifikuar të njëjtin e ka paraqitur në organet kompetente dhe se organet kompetente pasi që e kanë vërtetuar se nuk ka prova lidhur me dyshimin e arsyeshëm në

lidhje me veprën penale të falsifikimit të dokumentit, kallëzimin penal e ka hedhur si të tillë. Prandaj, gjykata me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të vërtetojë që i padituri të ketë paraqitur kallëzim të rremë penal dhe si i tillë nuk mund të mbahet përgjegjës vetëm se e ka paraqitur një rast para organeve kompetente.

Sa i përket dëmit jo material që pretendonte pala paditëse, neni 185 i LMD-së parasheh se *“E drejta e shpërblimit të dëmit në të holla për shkak të dhembjeve shpirtërore të pësuarra i takon personit, i cili me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtrimi ose varësie, është shtytur në marrëdhënie të dënueshme seksuale ose në veprim të dënueshëm seksual të panatyrshëm, si dhe personi ndaj të cilit është kryer ndonjë vepër tjetër penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit.”* Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, vërehet se ligjvënësi për cenim të dinjitetit ka paraparë disa situata të tjera, e që në shikim të parë është më se e çartë se paditësi nuk bënë pjesë në kuadrin e kësaj kategorie.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të palës paditëse përkatësisht të autorizuarit të tij, mirëpo të njëjtat ishin të pa rëndësishme për procesin, dhe nuk kishin ndonjë rol për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës. Më tutje gjykata konstaton se në duke ju referuar dispozitës së nenit: 7 të LPK-së sipas të cilit *“Palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK-së, *“Secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t’i provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, dhe pala paditëse nuk arriti që të provojë faktin se atij i është shkaktuar ndonjë dëm nga ana e të paditurit.

Vendimin që pala paditëse t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 449.1 dhe 452.1 të LPK-së, sipas të cilave të paditurit i pranohen shpenzimet ngase pala paditëse ka humbur kontestin dhe atë: për përpilimin e përgjigjes në padi 208.00 për katër seanca të mbajtura nga 270.40 euro për seancë, e gjithsejtë 1,289.60 euro, të llogaritur sipas tarifës së OAK për kontestet mbi 10,000.00 euro, pasi që këto janë shpenzime të cilat i janë shkaktuar palës së paditur.

Në bazën e të lartshënuarave u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.483/2021, më datë 26.03.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.